



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e V-të (pestë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 07 nëntor 2022

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Demokrat Hodolli, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa dhe z.Naile Ahmeti, dhe z.Selver Rama, ndërsa mungoi, z.Haki Rudari (*i cili ka dhënë dorëheqje nga cilësia e anëtarit të këtij Komiteti*)

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Liman Zeqiri dhe znj.Xhevrie Beqiri nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim-Podujevë, znj.Majlinda Gashi dhe z.Adem Ramadani nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, z.Ardian Emini nga Drejtoria e Arsimit-DKA, përfaqësuesi i OSBE z.Bekim Karaxhija, përfaqësues nga UNMIK z.Xhavit Fejza dhe z.Florent Salihu, dhe nga KFOR Vona Jozsef dhe Rasztik Zita.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, ndër të tjera theksoi, sigurisht se thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë me kohë, në ndër kohë nga zyrtari i zyrës ligjore kërkohet që Komiteti për Komunitete të delegoj 1 anëtar/e në Ekipin për të Drejtat e Fëmijës ashtu siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ që është nxjerrë tani nga niveli qendrorë, andaj si çështje kërkohet të përfshihet në rend të ditës.

Nëse ka të interesuar për të marrë fjalën rreth rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e hedhim në votim pikën shtesë fillimisht, pastaj rendin e ditës në tërësi.

Njëzëri mbështet kërkesa për përfshirje në kuadër të rendit të ditës edhe pika shtesë, dhe atë:

- ***Caktimi i një anëtar/je të Komitetit për Komunitete për delegim në përbërjen e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës***

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e hedhim në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe pikën shtesë që u mbështet paraprakisht.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri miratohet rendi i ditës sipas thirrje dhe materialit përkatës, përfshirë edhe pikën shtesë të cekur më lartë.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 14 tetor 2022

Njëzëri, pa plotësim ndryshime apo vërejtje eventuale, miratohet Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e datës 14 tetor 2022

2. Shqyrtimi i mundësive për sigurimin e lëndëve djegëse nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për ngrohje në sezonin dimëror familjeve në nevojë dhe me gjendje të rëndë ekonomike – sociale, me theks të veçantë për Komunitetet jo shumicë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, këtu kemi përfaqësuesit e Drejtorisë përkatëse, andaj ja kaloj fjalën për sqarime rreth kësaj çështje.

znj.Majlinda Gashi, zyrtare në DBPZHR, duke përshëndetur të pranishmit, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës më lejoni t'ju informoj se disa herë e kemi shqyrtuar mundësinë që t'ju i ndihmojmë. Më 01 mars 2022 kemi proceduar me këtë çështje i'u kemi drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal nëpërmes një shkrese përmes Kuvendit të Komunës me të cilën kemi kërkuar që të na mundësohet që t'i furnizojmë me lëndë djegëse familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, përkatësisht me dru për ngrohje, mirëpo e njëjta kërkesë fatkeqësisht është kthyer negativisht duke u bazuar në nenin 29 paragrafi 12 të Ligjit për pyjet e Kosovës i cili ndër të tjera thuhet kështu, *Mbrojtja e pyjeve si kompetencë delegohet nëpër Komuna, pastaj në shkronjën b) thuhet, konfiskimi i masës drusore nga shërbimi i mbrojtjes së pyjeve në Komuna është e hyrë e Komunës dhe procedohet në pajtim me dispozitat e prokurimit publik të Kosovës.*

Do të thotë masa drusore që është e konfiskuar e cila për momentin ndodhet në depon e përkohshme të sektorit të pylltarisë në fshatin Peran, mund të procedohet vetëm në përputhje me dispozitat e prokurimit publik të Kosovës, dhe çfarëdo forme tjetër e shpërndarjes së kësaj mase drusore është e kundërligjshme apo shkelje e ligjit gjë e cila është në mënyrë decitive me ligj.

Po ashtu gjatë këtij viti e kemi shqyrtuar edhe një formë tjetër e cika ka qenë shitje me pakicë apo shitje e lirë, formë të cilën e kemi filluar së pari në fshatin Majac në një ngastër me nr.20 përmes të cilës jemi munduar që masën drusore që ka qenë në atë ngastër ta shesim me një çmim shumë më të lirë se sa që është çmimi aktual i tregut, pra përmes kësaj forme jemi munduar që masën drusore ta shesim për 18 euro m², mirëpo fatkeqësisht numri i të interesuarve ka qenë shumë i vogël, konkretisht kemi pasë vetëm 2 kërkesa të tilla për shitjen e druve përmes kësaj forme. Pra edhe përkundër vullnetit shumë të madhe për t'ju ndihmuar këtyre rasteve jemi munduar disa herë t'ju ndihmojmë përmes kësaj forme dhe jo vetëm, por nuk ka pasë sukses.

Pra kjo ishte në pika të shkurtra, mirëpo nëse ndokush ka ndonjë pyetje apo diçka tjetër rreth kësaj pike, urdhëroni.

Zyrtari përkatës nga Zyra ligjore, vetëm sa për ta plotësuar parafolësen, ju sqaroj se lidhur me kërkesën që foli në fillim, ajo kërkesë në fakt është proceduar nga Kryetari i Komunës apo thënë ndryshme prej Ekzekutivi i Komunës/Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në Kuvendin e Komunës i cili edhe ka marrë vendim për shpërndarjen e druve të konfiskuara, për familjet me nevojë ekonomike dhe sociale, dhe pastaj ashtu siç kërkohet me legjislacion vendimi në fjalë është dërguar në Ministrinë përkatëse përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal, dhe si përfundim Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e ka vlerësuar si vendim në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, për shkak se drutë e konfiskuara shiten përmes prokurimit publik dhe nuk kanë të drejtë të dhurohen, shpërndahen e të ngjashme, pra ligji e

parasheh ashtu. Pra atë vendim në mbledhjen e radhës së Kuvendit të komunës e kemi anuluar sepse është procedurë e tillë kjo. Pra kjo ishte vetëm sa për plotësimin e parafolësës rreth procedimit, marrjes së vendimit në Kuvendin e Komunës si dhe vlerësimin ligjor nga Ministria përkatëse.

Kryesuesi i Komitetit, duke falënderuar parafolësit për sqarimet dhe informatat e dhëna, e hap debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, normale se kjo pikë është shumë me rëndësi në kohën, rrethanat dhe momentin që ne po jetojmë, dhe arsyeja përse kjo pikë është sjellë në harmonizim mes Kryesuesit të Komitetit dhe ne ve si ZKKK është duke parë gjendjen e rëndë ekonomike sociale, inflacionin e madh si gjendjes së rëndës që është, çoftë edhe globale.

Kuptohet se energjia elektrike është një element kryesor për jetesë dhe ne sipas informacioneve që kemi nga të gjithë mund të ndodh të kemi një dimër të ashpër e që mund të ketë edhe reduktim të energjisë elektrike, prandaj duke u bazuar në këto rrethana ne e kemi paraparë që ta trajtojmë këtë çështje në këtë mbledhje. T'ju them të drejtën unë sot isha në takim me drejtorin e DBPZHR i cili kishte shumë interesim të merrte pjesë në këtë mbledhje në mënyrë që t'i jap sqarime e tij dhe për të shqyrtuar mundësitë, format dhe mënyrat apo thënë ndryshe që t'i shterim të gjitha mundësitë në mënyrë që t'iu ndihmojmë njerëzve, qoftë edhe gjetjes së ndonjë donatori të mundshëm e që ka intenca dhe që ka bisedime në këtë aspekt me të vetmin qëllim që këtë gjendje ta zbutim sa do pak duke i'u ndihmuar familjeve në nevojë.

Arsyeja përse unë e them këtë është kjo për të cilën tani do t'ju informoj me një statistikë sipas të cilës kuptohet se është një numër jashtëzakonisht i madh që kanë nevojë. Në bazë të qendrës për Punë Sociale QPS – sektori i ndihmave sociale, të nacionalitetit Shqiptar janë 816 familje me 3677 anëtarë, të komunitetit Ashkali janë 72 familje me 381 anëtar/e, të Komunitetit Rom janë 5 familje me 37 anëtar/e, pra nga këto dy Komunitete (Ashkali dhe Rom) janë 418 anëtar/e në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, por që mund të ketë dhe ka edhe familje tjera që nuk janë sociale por që mund të jenë me gjendje sociale dhe që nuk marrin ndihmë, por mund të jenë në gjendje jo të mirë ekonomike kjo për shkaqe sepse në QPS janë edhe kriteret që duhet plotësuar për të marrë ndihmën sociale, prandaj nuk mund të themi se vetëm ai numër është, por mund të jetë numri edhe më i madh, sikurse që mund të jetë edhe tek komuniteti shumicë.

Pra nëse i referohemi gjithë këtyre dhe i mbledhim del se janë 893 familje me 4095 anëtar/e që marrin ndihmë sociale, dhe duke u bazuar në këto dhe në diskutimet që kemi pas me Kryetarin e Komunës dhe gjithë akterët tjerë me theks Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të cilët i falënderojë, në këtë muaj që jemi dhe klima vie duke u ndryshuar sepse jemi në stinën e dimrit, unë bëjë thirrje që kjo të merret seriozisht duke shqyrtuar mundësitë e ndihmës me dru për ngrohje familjeve në nevojë, natyrisht s për këtë çështje e kemi të ftuar edhe zyrtaren e DBPZHR e cila shumë mirë na informoj rreth përpjekjeve dhe aspektit ligjor që normale se çështja e druve të konfiskuara është paka kompetencë e instancave më të larta dhe çështje e prokurimit, por megjithatë ne depon e druve në fshatin Peran gjendje rreth 500 m³ dru, andaj është mirë të gjendjet mënyra, forma apo ndonjë model që familjeve në nevojë t'iu shpërndahen dru për ngrohje, pa anashkaluar edhe apsketin e gjetjes së ndonjë donatori eventual, qoftë edhe përmes prokurimit publike ku mund të ketë të interesuar që përmes prokurimit të siguroj dru për ngrohej familjeve në nevojë, gjithnjë në aspektin e humanitetit, në mënyrë që të sado pak të dalim prej kësaj situata e që edhe këto analiza dhe statistika ndoshta mund të jenë shqetësuese për ne.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderoj shefin e ZKKK-së për informatat dhe diskutimin e tij shumë të kurtë, mirëpo edhe pse i potencoj pothuajse të gjitha, unë dëshiroj të kyçem paksa rreth kësaj çështje.

U tha se janë rreth 500 m³ dru të konfiskuara që gjenden në depon në fshatin Peran, unë lus të gjithë akterët e Komunës së Podujevës që të na lejoj familjeve në nevojë qoftë të komunitetit jo shumicë qoftë të atij shumicë, një pjesë të atyre druve të lejoj shitjen e tyre me një çmim të lirë ashtu siç kanë vepruar edhe në disa Komuna tjera, kështu që ne si Komunitet sigurisht se do të merrnim pjesë në blerjen e tyre, ashtu siç e përcakton Komuna.

Pra e them këtë sepse vërtetë komuniteti jo shumicë, pa përjashtuar edhe atë shumicë, vërtetë këtë vit ka nevojë për ndihmë sepse siç jemi në dijeni ka shtrajtime të mëdha, ka inflacion të madh, kështu që ka nevojë dhe këtë e bazoj në vizitat dhe komunikimet e përditshme që kamë me perona të ndryshëm, me theks të komunitetit jo shumicë, madje qysh tani ende pa filluar dimri ndihet nevoja e sigurimit të lëndëve për ngrohje, e lëre më kur të fillon dimri i vërtetë.

znj.Majlinda Gashi, zyrtare në DBPZHR, theksoi, është fakt se disa prej Komunave kanë provuar mënyrën siç u përmend, mirëpo nuk di ndonjë Komunë e cila ka provuar me shitjen e masës drusore që është e konfiskuar. Ndërsa shitja e masës së caktuar drusore që është përmes formës me shitje të lirë në bazë të ftesave ashtu siç e ceka në fjalën hyrëse, mirëpo fatkeqësisht nuk kemi pasë të interesuar për t'i blerë ato, përveç 2 kërkesave që kanë qenë, pra fjala është për dru që janë në këmbë në ngastrat përkatëse ku qytetarët e interesuar shkojnë i shohin, aplikojnë dhe mund të paraqiten me kërkesa për blerje sipas procedurave të parapara nga Drejtoritë përkatëse, e që si formë është që përmes rojeve të pyllit qytetarët aplikojnë, i'u miratohet kërkesa, shkojnë në pyllin përkatës, i prejnë, i ngarkojnë dhe i marrin ato dru sipas sasisë përkatëse të përcaktuar nga Komuna, pra tërheqja e druve bëhet direkt prej ngastrave.

Pavarësisht kësaj ne do të shikojmë edhe Komunitat tjera të Kosovës nëse ndonjëra prej tyre e ka aplikuar ndonjë formë që drutë e prera pa leje dhe të konfiskuara t'iu shpërndahen familjeve në nevojë, nëse ka ndonjë formë sigurisht se do të ndërmarrim veprime që ta aplikojmë edhe ne.

Gjithashtu vlen të theksohet Agjencioni i pyjeve ka kërkuar rritjen e shfrytëzimit të masës drusore, gjë kjo e cila bëhet kryesisht në gjendje të jashtëzakonshme, kurse gjendja në të cilën jemi ne nuk mund të themi se është gjendje e mirë sepse situata me ekonominë nuk është e mirë dhe se çmimet janë shumë të larta, kështu që ne e kemi rritë shfrytëzimin edhe tek pyjet private duke zgjatur afatin e aplikimit të prerjeve në pyje private, kështu që ju bëjë thirrje dhe juve që jeni prezent që nëse njihni ndokënd që është i interesuar për aplikim për prerjen e pyjeve private t'i informoni ata se ende mund të aplikojnë.

Sa i përket sasisë së druve të konfiskuara që gjenden në depo, nuk është ajo që i cek por më e vogël, në fakt ka qenë një sasi 345 m³, mirëpo ka pas hyrje dalje, madje ka qenë edhe një kontratë për shitjen e masës drusore e cila është realizuar, dhe tani aktualisht kemi afërsisht kemi 300 m³ në atë deponi.

z.Adem Ramadani, zyrtar në DBPZHR, theksoi, do të doja të ndërhyjë edhe tek forma e shitjes së masës drusore në shumë 18 € që u cekë se është bërë në Komunën e Ferizajt. Ne kemi qenë afërsisht 1 muaj para Komunës së Ferizajt që kemi pasë shitje me pakicë të druve për ngrohje në shumë 18€, kurse Komuna e Ferizajt në fakt këtë çmim e ka pasë 18.60€, mirëpo të mos kuptohet se ajo masë drusore ka qenë dru i gatshëm, por përmes kësaj forme të shitjes është ashtu siç janë në pyll, i pa prerë për një çmim prej 18€, kurse dhe gjitha punët tjera i bartë pala që aplikon, shitje e cila ka qenë deri në 7m³, për një familje. Forma e cekur ka qenë e publikuar nëpër mjetet e informimit dhe në rrjete sociale dhe secili ka mund të jetë i informuar.

Pra ne kemi qenë para Ferizajt për rreth 1 muaj, kurse ata kanë qenë para neve 1 hapë me plasim të lajmit në media, ndërsa për drutë që gjenden në depo është një procedurë tjetër.

Pra kjo ishte vetëm sa për të qenë të sqaruar të gjithë rreth çështjes në fjalë, që ne si Komunë kemi qenë 1 muaj para Komunës së Ferizajt që kemi aplikuar formën e shitjes me pakicë të druve ashtu siç janë në pyll, në shumë 18€, kurse shpenzimet dhe punët tjera i ka bartë vet pala.

Vlen të theksohet se Komuna e Podujevës ka 633 km², dhe mund të themi se kemi pyje më shumë se cilado komunë tjetër në Kosovë.

znj.Majlinda Gashi, zyrtare në DBPZHR, theksoi, këto forma zakonisht rekomandohen nga Agjensioni i Pyjeve sepse ai menaxhon me komplet me sektorin e pylltarisë në Kosovë, pra janë forma të rekomanduara varësisht se si e shohin të arsyeshme e që në këtë rast në situatën që jemi pothuajse është e arsyeshme dhe që ka nevojë për shitje të lirë, mirëpo tek ne nuk e di përse nuk ka pasë suksese. Një gjë të tillë ne do ta provojmë sërish edhe në lokacione tjera varësisht rekomandimeve të Agjenionit Pyjor të Kosovës.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, në rast se sërish do të bëhen shitje të tilla në formën se si u potencua do të ishte mirë të njoftohej z.Liman Zeqiri dhe përmes këtij sigurisht se do të jemi të njoftuar edhe ne si komunitet jo shumicë në mënyrë që të marrim pjesë në atë proces të shitjes

z.Demokrat Hodolli, theksoi, falënderoj 2 zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për prezencën e tyre në kë mbledhje, informatat e dhëna dhe për vullnetin e mirë për sigurimin e lëndëve djegëse për familjet në nevojë, pavarësisht përgjigjes negative nga ana e Ministrisë përkatëse.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, konsideroj se diskutimet përfunduan, falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë rreth kësaj çështje.

3. Informatë rreth vizitave në tri (3) Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta të Qytetit (“Dr Ibrahim Rugova”, “Shaban Shala”, “Naim Frashëri”) rreth procesit gjithëpërfshirës mësimor në të cilin përfshihen edhe nxënësit e Komunitetit jo shumicë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, lidhur me këtë temë prezent kemi përfaqësuesin e Drejtorisë së Arsimit i cili mund të na jep informata dhe statistika të ndryshme

z.Ardjan Emini, zyrtar në DKA, theksoi, rreth vizitave nuk do të hyja sepse edhe nuk kam qenë në vizita, kurse në rast se keni diçka të paqartë rreth arsimit, mund t’ju sqaroj apo të jap ndonjë informatë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, lidhur me vizitat e bëra, theksoi, ne së bashku me shefin e ZKKK dhe me disa anëtar/e të Komitetit për Komunitete kemi vizituar 3 shkollat e cekura në këtë pikë të rendit të ditës, dhe kemi parë nga afër procesin mësimor në këto shkolla, me theks nxënësit e komuniteteve jo shumicë sa i përket zhvillimit të mësimit qoftë ku ulen, qoftë si kalojnë, qoftë për ndonjë pengesë eventuale, aspektin e braktisjes së shkollave, notimeve, interesimit të prindërve të tyre, sjelljet e tyre, dhe çështje tjera.

Në shkollën “DR Ibrahim Rugova” jemi pritë nga Drejtori i shkollës nga i cili jemi informuar në mënyrë të detajuar për të gjitha mënyrat e zhvillimit të mësimit të nxënësve të komunitetit jo shumicë, drejtor me të cilin ne kemi punuar edhe më parë dhe e njohë, mirëpo këtë herë më ka befasuar për të mirë. Kemi parë nga afër kabinetet dhe laboratorët e dhuruara me buxhet të Donatorëve dhe ato me buxhet të Komunës, dhe nxënësit e komuniteteve kanë qasje në të gjitha ato kabinete dhe laboratorë. Në këtë shkollë janë gjithsej 72 nxënës të komunitetit ashkali, nga

niveli parashkollorë deri në klasën e IX-të, të tjerë nuk ka në atë shkollë. Mirëpo vlen të theksohet se në atë shkollë është ndier mos funksionimi i Qendrës për mësim shtesë, gjë të cilën edhe drejtori i shkollës e potencoi këtë, kjo ngase në atë Qendër kanë marrë pjesë të gjithë nxënësit, jo vetëm ata të komunitetit jo shumicë, ku kanë pasë përkrahje në detyra, me mjete didaktike që ofruara nga Drejtoria qendrore e Qendrës për mësim shtesë, prandaj jemi ndarë shumë të kënaqur me zhvillimin e mësimin të nxënësve të komunitetit jo shumicë në atë shkollë, me përjashtim të disa mungesave të disa nxënësve të cilëve jua kemi marrë emrat dhe që na duhet të intervenojmë sepse pothuajse të njëjtit janë para braktisjes së shkollimit, prandaj ne do të bisedojmë me prindërit e tyre dhe do shohim çfarë mund të bëjmë edhe pse unë jam munduar të komunikoj me prindërit e atyre nxënësve por që nuk kam mundur, por unë e kam një ekipe në atë lagje dhe do t'i angazhoj të bisedojnë me prindërit e tyre dhe të më japin informata se çfarë është në pyetje.

Në vizitën e bërë në shkollën “Naim Frashëri” ku jemi pritur nga Sekretarja e shkollës dhe UD e detyrës së Drejtorit, nga e cila po ashtu jemi informuar në përgjithësi rreth zhvillimit të mësimin të nxënësve të komunitetit jo shumicë për çka u tha se probleme të theksuara nuk ka, të gjithë janë të integruar në shkollë dhe nëpër klasa, pastaj nuk ka kurrfarë dallimesh ndaj tyre qoftë në vendet e tyre ku ulen apo si janë të sistemuar. Në këtë shkollë kemi 73 nxënës të komuniteteve jo shumicë të cilët vijnë në mësimin. Sërish u potencua çështja e mos funksionimit të Qendrës për mësim shtesë e cila ka qenë në shkollën “Shaban Shala” e që nxënësit e kësaj shkolle kanë shkuar në atë Qendër e që ajo që është më interesantja se nga mësimi shtesë në Qendër nxënësit kanë qenë më të përgatitur ngase qoftë detyrat qoftë mësimin shtesë e kanë zhvilluar në atë Qendër prandaj edhe suksesi nuk ka munguar.

Pastaj në vizitën e bërë në shkollën “Shaban Shala” ku edhe aty jemi pritur nga drejtori i shkollës nga i cili jemi informuar rreth vijimit të mësimin të nxënësve të komuniteteve jo shumicë, madje me emra dhe mbiemra të nxënësve që kanë më shumë sukses.

Numri i nxënësve të komunitetit jo shumicë në shkollat e mesme është 15, dhe shumica prej tyre kanë marrë bursa nga Komuna.

Pra kjo ishte informata ime sa i përket vizitave në tri shkollat e cekura.

z.Ardian Emini, zyrtar në DKA, theksoi, ne si DKA jemi të përkushtuar për kushte sa më të mira për të gjithë nxënësit pa dallime e në veçanti për kategoritë e veçanta siç janë edhe nxënësit e komuniteteve jo shumicë, ata me nevojën të veçanta dhe të tjerë.

Ne si DKA së bashku edhe me donatorë të ndryshëm kemi ofruar dhe kemi arritur t'i pajisim shkollat, sidomos ato që kanë nxënës të komuniteteve jo shumicë, me laboratorë të ndryshëm qoftë të shkencave natyrore, qoftë pajisje elektronike e të tjera dhe jemi të përkushtuar që ky trend të vazhdoi edhe tutje.

Po ashtu së bashku me z.Xhafer Ademin kemi hartuar Planin zhvillimor për integrimin e arsimit dhe arsimit gjithëpërfshirës të këtyre kategorive të nxënësve, së bashku edhe Organizatën GIZ.

Sa i përket mos braktisjes së shkollimit nga nxënësit e komuniteteve jo shumicë kemi ofruar edhe kampanja vetdijesuese për regjistrimin e tyre në shkolla dhe efektet e shkollimit e që kemi arritur bashkërisht me komunitetin jo shumicë, qoftë me prindërit e tyre qoftë me drejtorët, zëvendësdrejtorët dhe gjithë akterët e shkollave, ngase pa u përfshirë të gjithë akterët nuk mund të kemi suksese pastaj në këtë drejtim ngase ta zëmë nëse një prind nuk bashkëpunon me përfaqësuesit e komuniteteve ose me drejtorinë shkollës, nxënësi mund të mos shkoj në shkollë dhe mund të vije pastaj deri tek braktisja e shkollimit.

Sa i përket numrit të nxënësve, aktualisht në Komunën e Podujevës kemi 15141 nxënës, nga këta janë 176 të komuniteteve jo shumicë, të integruar në gjithsej 8 shkolla, (2 shkolla të mesme dhe

6 shkolla fillore), ndërsa sa i përket çështjes së diskriminimit, ne nuk e kemi këtë problem sepse sigurisht që ju edhe vet e keni parë gjatë vizitave të bëra se nxënësit e komuniteteve jo shumicë procesin mësimor e zhvillojnë bashkërisht me nxënësit e komuniteteve shumicë, madje ndoshta keni mund të hasni në ndonjë rast ku janë të ulur në një bankë nxënës të komunitetit jo shumicë dhe të atyre shumicë, madje madje edhe të gjinive të ndryshme, prandaj kjo tregon se nxënësit nuk diskriminohen në asnjë formë, janë nxënës dhe fëmijë tanë. Ne si Komunë merremi shembull nga Komunitat tjera se si i trajtojmë nxënësit e komuniteteve jo shumicë.

Megjithatë ka nevojë shumë më shumë të punohet dhe ne do të vazhdojmë të punojmë bashkërisht me të gjithë akterët që t'iu ofrohen kushte më të mira të gjithë nxënësve.

Sa i përket çështjes së Qendrave mësimore, ne si DKA jemi munduar të bëjmë zgjidhje mirëpo për shkak të anës ligjore e cila na ka sanksionuar, por që kemi nënshkruar një Memorandum të Bashkëpunimit me Organizatën VORAE, por për shkak të procedurave ligjore nuk kemi munduar t'i fusim ata mësim hënës në listat e pagave ngase janë kërkuar disa kriteret për t'i përfshirë ata mësimdhënës që kanë punuar deri tani, por për shkak të ankesave është anuluar dhe tani jemi në përpjekje për të gjetur një zgjidhje dhe varianti se si mund t'i funksionalizojmë këto Qendra dhe t'i fusim ata mësimdhënës në listat e pagave në mënyrë që nxënësit e komuniteteve jo shumicë të kenë mundësi të zhvillojnë mësim shtesë, pa përjashtuar edhe nxënës të komunitetit shumicë edhe pse me Udhëzimin Administrativ përkatës secili mësimdhënës është i obliguar të mbaj mësim shtesë jashtë normës mësimore të cilën e ka.

Diçka tjetër nuk kam rreth kësaj çështje, mirëpo nëse dalin pyetje apo kërkesa për sqarime shtesë, mund të japim gjithsecilit.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, nga pozicioni im dhe i ZKKK që kemi angazhime çdo herë kam dëshirë që fillimisht t'i dëgjoj të tjerët e pastaj të jap përgjigje dhe sqarime për aq sa kem mundësi.

Në mbledhjen e kaluar nuk kam mund të jem prezent, mirëpo e kam lexuar procesverbalin me vëmendje dhe sinjerisht ju them se nuk më kanë pëlqyer disa gjëra e të cilat sigurisht se duhet t'i themi qartë dhe t'i sqarojmë sepse në rast se heshtim dhe nuk e themi të vërtetën atëherë do të dalim jo seriozë në punë dhe në institucionet tona. Arsyeja është dhe që bashkërisht edhe i vizituar tri shkollat për të cilat u dha një informatë nga Kryesuesi i Komitetit dhe nga zyrtari parafolës i DKA-së të cilin e falënderoj sepse është organ kompetent për të dhëna të sakta.

Unë për Komunën e Podujevës e kam thënë një thënie dhe sërish i qëndroj pas sepse tek ne ka kaluar faza e integritit, madje e kam thënë se jemi në fazën e normalizimit të një jete dhe të një shoqërie në qytet apo edhe për një stabilizim ekonomik të gjendjes së atyre që nuk janë me gjendje të mirë ekonomike e që në këtë bëjnë pjesë bëjnë pjesë edhe familje të komunitetit shumicë sepse po e përsërisë se jemi duke jetuar në një gjendje jo të mirë dhe në rrethana jo të mira në këtë aspekt.

Fjala diskriminim, është fjalë e cila nuk ekziston në Komunën e Podujevës, por mund të vie në shprehje fjala diskriminim pozitiv ngase të gjitha kapacitetet tona si shoqëri dhe si komunitet shumicë në këto 20 vite që punojë e kemi quajtur në shërbim të atyre që njihen numerikisht, jo sepse ne jemi bashkëqytetar, ne bashkëjetojmë, të gjitha shërbimet i bëjmë bashkërisht, secili secilit i dalim në ndihmë andaj dhe po ju them këtu botërisht hapur që asnjë diskriminim nuk ka pasë pas luftës në Komunën e Podujevës, nga asnjë komunitet ndaj asnjë nacionaliteti tjetër, qoftë edhe ata të cilët neve na kanë dëmtuar në luftë, e që unë i kam thënë hapur në çdo takim, por përkundrazi kemi treguar një kulturë, një demokraci, një tolerancë, një angazhim, një mundësi dhe një solidaritet të jashtëzakonshëm për njeri tjetrin.

E di se ndonjëherë ndonjë referencë i vije njeriut që mund të ndihet jo mirë në kuptimin e anës materiale e që mund t'i ndodh secilit, mirëpo ne duhet ta kalojmë veten dhe të mos përdorim terme të tilla të cilat natyrisht se mbesin pastaj në procesverbale.

Ju them këtu se nuk po dëshiroj të bëjë debat tani, mirëpo me vëmendje e kam lexuar procesverbalin pasi nuk kam mundur të jem prezent në atë mbledhje për shkak se kam qenë në një trajnim, mirëpo jam angazhuar së bashku me OSBE-në ku kemi shkuar në takim me drejtorin e DKA-së z.Avni Fetahu dhe e kemi sqaruar shumë mirë çështjen e Qendrave të mësimi shtesë në dy shkollat përkatës që ato Qendra kanë punuar në bashkëpunim me OJQ-në Zëri i Romëve Ashkalive dhe Egjiptasve VORAE përmes një Memorandumi të Bashkëpunimit, e që ende konsideroj se duhet të vazhdoj por që janë disa faza ligjore të cilat u shpjeguan më parë nga parafolësit, mirëpo mjetet buxhetore ekzistojnë dhe do të gjendet forma dhe mënyra për tu bartur tek ata persona që kanë punuar, pavarësisht vonesave që jemi, po megjithatë mjetet financiare për atë çështje janë të koduara dhe nuk mund të përdoren për diçka tjetër apo të keqpërdoren në ndonjë formë tjetër, andaj për këtë ne kemi marrë për obligim së bashku me OSBE-në dhe zyrtarë tjerë që të angazhohemi të gjejmë forma dhe mënyra, duke marrë edhe praktika nga Komuna tjera, në mënyrë që të bëhet bartja e mjeteve buxhetore.

Fakti që numri më i madh i nxënësve të komuniteteve jo shumicë janë në shkollat “DR Ibrahim Rugova” dhe “Naim Frashëri”, që numerikisht ka nxënës më shumë të komunitetit jo shumicë në shkollën Shaban Shala faktikisht është ajo që ika dhënë përkrahje kësaj forme që ka nevojë ndoshta edhe procesi i mbajtjes së mësimi shtesë të jetë edhe për nxënësit e komunitetit shumicë por me theks të veçanta që ka pasë edhe disa arsye shtesë në qoftë se hyjmë ne çështjet ekonomike që kanë përfituar edhe komuniteti shumicë bashkërisht me atë pakicë e që kanë pasë edhe një element të shujtave. Ne jemi në dijeni nga Ministria se mësimi i ciklit të ulët, mirëpo mësimi shtesë që ka qenë pas orarit i'u ka ndihmuar atyre nxënësve në këtë kontekst, për çka drejtorët e shkollave u falënderuan, prandaj konsideroj se ky proces do të vazhdoj dhe për këtë do të angazhohemi qoftë si organe kompetente të Komunës qoftë si ZKKK, në mënyrë që të zgjidhen problemet po nuk mund të themi dhe të përdoren fjalë që nuk ekziston në fjalorin tonë, por mund të përdoret fjala diskriminim pozitiv për një jetë më të mirë të qytetarëve, dhe mendoj se në bazë të rrethanave dhe përvojës tonë jemi duke u munduar t'iu dalim në ndihmë qytetarëve tanë pa dallime.

Një gjë e cila më brengosi në ato vizita nëpër shkolla ishte fakti që 5 fëmijë nxënës të komunitetit jo shumicë në shkollën “Dr Ibrahim Rugova” nuk e vijnë procesin mësimor, ekipi mobil është i themeluar dhe është shumë aktiv në atë shkollë e që normale se kanë kontaktuar me prindërit e tyre por që arsyeja është gjendja e rëndë ekonomike andaj në mungesë të kushteve ekonomike ata fëmijë detyrohen të punojnë punë të rënda e që është e sanksionuar dhe e ndaluar edhe me ligj ku nën moshën 18 vjeçare nuk mund të punojnë fëmijët në punë të rënda, për çka është Ekipi special që merret me monitorimin e punëve të rënda të fëmijëve, mirëpo ne në bashkëpunim me prindërit e tyre, DKA-në dhe Ekipin në fjalë do të bëjmë çmos që ata fëmijë t'i kthehen shkollimit, sikurse që ishte një vajzë edhe në shkollën “Naim Frashëri” .

kjo ngase e kemi obligim si shoqëri, si njerëz dhe si institucione që t'i kushtojmë një rëndësi të veçantë arsimit dhe të mundohemi me të gjitha mundësitë, madje edhe jashtë mundësive si Komunë që ta stabilizojmë komunitetin jo shumicë sepse ne bashkëjetojmë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë e kam vetëm një pyetje, a është aprovuar buxheti i Komunës për vitet e ardhshme dhe a është paraparë buxhet për funksionimin e Qendrave për mësim shtesë, konkretisht nëse është miratuar është dashtë të përfshihet edhe buxheti për mësimdhënësit e Qendrave në mënyrë që të funksionalizohen dhe të funksionojnë, përndryshe nëse nuk është paraparë buxhet sërish do të ketë probleme dhe nuk do të mund të funksionalizohen ato Qendra.

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK, theksoi, lidhur me Qendrat e mësimin shtesë, është e përfshirë një Organizatë me të cilën është nënshkruar një Memorandum i Bashkëpunimit, andaj në kuptimin institucional e them se nuk mendoj se është paraparë buxhet shtesë ngase është një Organizatë e cila e mbështetë këto Qendra kurse ne si Komunë i kemi marrë obligimet tona.

z.Ardian Emini, zyrtar në DKA, theksoi, sa i përket kësaj konsideroj se nuk kemi ndonjë telashe sepse buxheti për Qendra lëshohet nga niveli Qendrorë, do të thotë Thesari lëshon pagesat, kështu që ne i kemi të ndara mjetet buxhetore dhe ato mjete qëndrojnë në buxhet, pra janë të pashpenzuara për diçka tjetër por vetëm për pagesat e mësimdhënësve të Qendrave, pra i kemi të koduara në buxhetin e Komunës.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, jam i njoftuar se mjetet buxhetore për këtë çështje janë të ndara dhe qëndrojnë në buxhet, kështu që ato mjete mendoj se do të dalin mësimdhënësve që kanë punuar qoftë përmes rrugës ligjore qoftë përmes projektit, përndryshe do të mbesim me këto probleme që jemi dhe Qendrat nuk do të funksionalizohen.

z.Ardian Emini, zyrtar në DKA, theksoi, jemi në këtë gjendje dhe besoj se do të bëjmë zgjidhje sa i përket atyre mësimdhënësve të mësimin shtesë në listat e pagave.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, konsideroj se ata mësimdhënës kanë humbur pagat, mirëpo nxënësit kanë humbur më shumë sepse kanë humbur mësimin

z.Ardian Emini, zyrtar në DKA, theksoi, fakt që nxënësit kanë humbur orët e mësimin shtesë mirëpo orët e rregullta të mësimin nuk i kanë humbur.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, e dini se unë kam një Qendër në lagjen ku jetojmë dhe kam shumë nxënës të cilët vijnë për t'iu ndihmuar në detyra dhe çështje tjera mësimore sepse ka prindër të cilët nuk dinë t'jua shpjegojnë fëmijëve të tyre detyrat, madje ka ndodhë që jam konsultuar edhe me profesor të shkollave për detyra ngase janë disa që vërtetë nuk kemi mundësi as ne t'i zgjidhim. Prandaj kërkoj që gjithsesi të përshpejtohet procesi i funksionalizimit të qendrave të mësimin shtesë.

z.Ardian Emini, zyrtar në DKA, theksoi, ne si DKA jemi në përpjekje për të përshpejtuar procesin e funksionalizimit të Qendrave, mirëpo unë e ceka edhe më parë se mësimdhënësit janë të obliguar të mbajnë mësim shtesë, prandaj të gjithë ata nxënës të cilët kanë nevojë dhe që nga ju i nderuar Kryesues kërkojnë ndihmë, ju lus që të na japni emrat e tyre dhe me cilët mësues janë sepse mësimdhënësi është i obliguar që t'i mbaj 4 orë shtesë në javë me ata nxënës që kanë nevojë për mësim shtesë, andaj ju i nderuar Kryesues nuk keni nevojë të bëheni telashe dhe t'i lëni anash obligimet familjare dhe të merreni me ata nxënës sepse ajo është detyrë e mësimdhënësit.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin, mirëpo ne të gjithë jemi në dijeni se veprojnë nxënësit pasi të kthehen nga shkolla (shembull, ushqehen, lozin paksa) dhe pastaj i'u bie ndërmend se kanë detyra dhe marrin për t'i kryer ato.

znj.Sevdije Mustafa, theksoi, në vizitat që u janë bërë shkollave të cekura nuk kam mundur të jem prezentë për arsye personale, edhe përkundër dëshirës që kam pasë të jem prezentë, nuk e di se a e keni parë klasën në shkollën "Shaban Shala" ku kemi mësuar ne si Qendër, ne mësimin e kemi zhvilluar nën shkollën e objektit, unë i kam pasur 37 nxënës por hapësira ka qenë e

mjaftueshme vetëm për 9 nxënës, ndërsa 3 grupe kanë qenë në shkollën “Naim Frashëri”, por që më është dashur të bëjë një kombinim të grupeve që nxënësit të mos largohen nga Qendra, pra ka qenë shumë gjendje e rëndë.

z.Ardian Emini, zyrtar në DKA, theksoi, është fat i mirë se sallën e edukatës fizike e cila ka qenë e pa shfrytëzueshme e kemi ndarë në 3 pjesë (3 klasë) për kabinete dhe një klasë të veçantë për mbajtjen e mësimit shtesë për juve si Qendër.

znj.Sevdije Mustafa, theksoi, fjalën diskriminim e kam përdorë jo diskriminimin në aspektin që ka ndodhur në klasa sepse e di gjendjen e tyre, por për gjendjen që kemi pasur gjatë kohës që kemi zhvilluar mësimin në si Qendër në kushte shumë të vështira, madje edhe pa ajrosje të mjaftueshme kemi punuar në atë gjendje dhe për një vit të tërë, vetëm e vetëm që nxënësit e komitetit tonë ta kenë një sukses më të madh. Pra kjo ka qenë arsyeja që e kam përmendur fjalën diskriminim në atë mbledhje.

z.Ardian Emini, zyrtar në DKA, theksoi, e dimë që ka qenë mungesë e hapësirës, kur është bërë Memorandumi i Bashkëpunimit në kemi kërkuar dhe jemi angazhuar në aspektin se si mund të bëjmë një zgjidhje, mirëpo kjo ka qenë zgjidhje e përkohshme momentale, nuk ka qenë zgjidhje e përgjithshme por vetëm deri sa të bëhet një zgjidhje tjetër e që tani siç e tregova në sallën e Edukatës Fizike e cila ka qenë e pa shfrytëzueshme e kemi ndarë një klasë të veçantë për mësimit shtesë për juve si Qendër e mësimit shtesë.

znj.Sevdije Mustafa, theksoi, kemi qenë 2 kolege duke punuar dhe i kemi ndarë nxënësit e shkollës “Shaban Shala” nuk kanë qenë nxënës të komunitetit jo shumicë por nxënës të komunitetit shumicë, koleges i është siguruar klasa dhe kabineti i informatikës, kurse mua jo, andaj dëshiroj ta di përse për kolegen ka qenë mundësia e tillë dhe i është bërë zgjidhje, kurse mua jo.

z.Ardian Emini, zyrtar në DKA, duke i’u përgjigjur parafolësës theksoi, përse nuk keni kërkuar informacione lidhur me këtë çështje.

znj.Sevdije Mustafa, replikë me parafolësin theksoi, kam kërkuar informacione lidhur me këtë çështje.

z.Demokrat Hodolli, theksoi, ju përgëzoj i nderuar kryetar sepse kemi marrë informata të mjaftueshme se sa nxënës të komunitetit jo shumicë janë në shkolla të Podujevës dhe kisha dashur një pyetje për Ju pasi që jemi në dijeni sa nxënës të komuniteteve e vijnë mësimin në shkolla të mesme dhe ato fillore, dua ta dijë sa nxënës e vazhdojnë mësimin e lartë e tutje.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, duke i’u përgjigjur parafolësit theksoi, për momentin i kemi vetëm 3 studentë të komunitetit jo shumicë që vijnë arsimin e lartë.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, jemi 3 studentë që vajojmë shkollimin e lartë, unë që jam në Fakultetin e Mjekësisë (Fizioterapi), motra ime në Fakultetin Juridik dhe 1 tjetër në Fakultetin Juridik.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, duke parë se nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e përfundoj këtë pikë të rendit të ditës.

4. Caktimi i një anëtari/je të Komitetit për Komunitete për delegim në përbërjen e Ekspertit për të Drejtat e Fëmijës

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, lidhur me këtë çështje u sqaruam në fillim të mbledhjes, andaj a ka ndonjë propozim lidhur me caktimin e një anëtari/je të Komitetit për Komunitete për delegim në përbërjen e Ekspertit për të Drejtat e Fëmijës.

znj. Sevdije Mustafa, theksoi, anëtari i deleguar nga Komitetit për Komunitete, në Ekipin për të Drejtat e Fëmijës propozoj të jetë z.Xhafer Ademi i cili konsideroj se ka një përvojë dhe është Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse dëshiron ndokush tjetër fjalën, nëse jo atëherë e kemi një propozim dhe atë e hedhim në votim.

Njëzëri nga të pranishmit mbështetet propozimi i znj. Sevdije Mustafa që anëtari i deleguar nga Komitetit për Komunitete, në Ekipin për të Drejtat e Fëmijës të jetë z.Xhafer Ademi kryesues i Komitetit për Komunitete.

5. Të ndryshme

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, dëshiroj të falënderoj Organizatën IOM përkatësisht zyrën e Bashkësisë Evropiane e cila është financuese, dhe e cila ka kontribuar dhe po vazhdon të kontribuoj ende në Komunën e Podujevës dhe jemi në kontakte të vazhdueshme për t'i ndihmuar komunitetit jo shumicë për stabilizimin ekonomik të jetës së tyre.

Edhe pse nuk është mirë të përmenden të mirat dhe ndihma që i bëhet ndokujt, por për shkak të transparencës ju informoj se javën e kaluar familja e Hajriz Bajramit ka fituar një donacion prej 4300 € me pjesëmarrje të tij me një shumë 300 € si participim, kurse 4000 €.

Janë vizituar edhe rreth 10 familje që kanë fituar me projekte në shuma rreth 4000 € - 5000 € e që janë familje të komuniteteve jo shumicë më shumë, pra bashkërisht me neve dhe përfaqësuesit e komuniteteve siç është tani Xhafer Ademi, e që më parë ka qenë ish Kryesuesi Shaban Ahmeti, e që vazhdimisht janë ndihmuar këto familje. Në këtë trend kemi vazhduar dhe jo vetëm që kanë përfituar familjet nga këto donacione, jo vetëm që kanë përfituar mjete të punës dhe për të hyra të veta dhe për familje si dhe për vetëpunësim dhe rigjenerim të të hyrave për ta rritur kapacitetin e veprimtarisë që kanë, por edhe i kanë ndihmuar edhe shumë Qendrave dhe për këtë ne e dimë se sa kabinete kanë ardhur në emër të komunitetit, andaj për këtë po e them se duhet të jemi falënderues sepse në ato shkolla mësojnë të gjithë nxënësit dhe tani mund të themi se ajo është pasuri shumë e madhe ngase kemi kabinete të ndryshme në shkolla siç janë shkollat “DR Ibrahim Rugova”, “Naim Frashëri”, “Shaban Shala”, “Luigj Gurakuqi” etj, dhe tani jemi në përfundim të realizimit të projekteve të tilla edhe në shkollat tjera ku ka nxënës të komuniteteve jo shumicë. Pra jemi në këto procese dhe jemi në kontakt të vazhdueshëm me zyrtar të IOM të cilët na përkrahin vazhdimisht për një jetë më të mirë dhe për stabilizim ekonomik si dhe për diskriminim pozitiv, dhe këtë që po ju them mbajeni në mend se në Podujevë nuk ka diskriminim, Podujeva është shembull në Kosove për një jetë normale për qytetarë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, dua të shtoj edhe diçka, unë kur kam qenë mediatorë i arsimit, Komuna e Podujevës ka qenë e para në nivel Kosove lidhur me arsim, tani nuk jam shumë në rrjedha dhe nuk e di si qëndron gjendja.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, unë foli me fakte dhe se të mirat nuk bënë t'i harrojmë, nganjëherë e kam tejkualuar vetveten dhe e kam tejkualuar ndoshta formën ligjore, këtu e kam edhe dokumentin e OSBE-së, shembull, në qoftë se unë nuk jam i autorizuar të lëshoj dokumente të verifikimit ngase është letërnjoftimi është pasaporta dhe në të shënojnë të dhënat personale siç janë emri dhe mbiemri, nënshtetësia Kosovare, dhe nuk shkruan etnia), megjithatë me qëllim për

t'ju ndihmuar, të nderuar vetëm këtë vit për të përfituar bursa ata nxënës, unë i'u lëshoj edhe vërtetime me nënshkrim timin dhe me vulë, prandaj një vërtetim të tillë e posedon edhe ti që ju është lëshuar në vitin 2018 (i drejtohet anëtares së komitetit znj. Sevdije Mustafa), prandaj për këtë arsye po e them që të mos përdoret shprehja diskriminim sepse nganjëherë ka raste kur zyrtari e rrezikon edhe punën e tij për t'i ndihmuar dhe për t'i dalë në ndihmë tjetrit që është i komunitetit jo shumicë.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11;10

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.prot.01-060/04-0093559/22
Podujevë, 07 nëntor 2022**

**Kryesuesi i Kuvendit
Xhafer Ademi**